



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Vau Dejes, më _____._____.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: LOTI II “Ndertim ure ne Ashte, Bashkia Vau Dejes”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45- Punë
ndertimore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: prej 3.265.949 (tre milion e dyqind e gjashtedhjetë e pesë mijë
e nëntëqind e dyzet e nëntë)Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës , sipas Shtojcës 3

Në masën 2% të fondit limit, vlera 65 319(gjashtedhjetë e pese mijë e treqind e nentemdhjetë)lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit (2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në të dy bilancet e kerkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*” (i ndryshuar).

Shenim : Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 (sipas kesteve të maturuara) sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vetë. ((Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit; **(nese leshohet)**
- Certifikaten e marrjes ne dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti; **(nese leshohet)**
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 shkronja a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa vlera limit e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-7 Niveli A “Barriera dhe mbrojtje rrugore”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

❖ **Parashikohet edhe mundësia e ekuivalentimit të licencave profesionale për operatorët e huaj.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, perkatesisht si me poshte;

“N.P. 1 Punime germimi në tokë

*Konsiderohen **gërmimet**, sistemimet dhe **ndryshimet në volum** të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.*

N.P. 4 Rrugë autostrada, *ura*, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, **betonarme të thjeshtë** dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

*Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve, si: **guard rail**, new jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.*

N.S - 18 Punime topogjeodezike

*Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, **punime topogjeodezike në objekte inxhinierike**, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Shuma 1,2,3 e preventivit	Niveli A	44,956.56

<u>Kategoria</u> NP-4	Rruge ,autostrada,mbikalime	Shuma 4, 5 , 6 , 7 , 8 , 9,10,11 e preventivit	Niveli A	3,070,921.87
<u>Kategoria</u> NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore	Shuma 12 e preventivit	Niveli A	151,882.56
<u>Kategoria</u> NS-18	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me projekt inxhinierik te ndertimit te nje ure dhe duhet te behet piketimi i sakte i dimensioneve sipas projektit . Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik/Ing Ndertimi të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për te pakten muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera).

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë liçencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e liçensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.3.a) Vetdeklarimin nga inxhinierat se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.

2.3.4 Kapaciteti Teknik dhe Profesional (Burimet Njerëzore)

2.3.4.1 Stafi inxhinierik dhe teknik:

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me diplome dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërise si dhe të disponojë kontrate pune të vlefshme.

Pergjegjesi teknik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate me kohe pune të plote në objekt, e cila do të bashkeshoqerojë deklaratën e subjektit.

(bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”).

b) 1 (një) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me kontrate pune të vlefshme dhe diplome.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se do të jetë i disponueshëm në kantier gjatë realizimit të kontratës.

c) 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder

Inxhinieri topograf/Gjeodet/Markshajder duhet të jetë i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune të vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Nga ana teknike, numri i burimeve njerëzore dhe stafi inxhinierik është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut të zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 90 diteve kalendarikë nga data e

nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Është kërkuar **inxhinier ndërtimi (Drejtues Teknik)** për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e preventivit, projektit dhe specifikimeve teknike. Drejtuesi teknik është përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës sipas projektit, kushteve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë. Gjithashtu, ai është përgjegjës për hartimin e projektit teknik 'As-Built' si dhe projektit të mirëmbajtjes së objektit në përfundim të punimeve. Krahas tij, është kërkuar një **Inxhinier Ndërtimi** me qëllim që të garantohet prania dhe ndjekja e përditshme teknike e punimeve në kantier, nën udhëzimet e drejtuesit teknik, pa krijuar vonesa në grafikun e zbatimit të projektuar nga ing. Gzim Likaj . Vetëdeklarimet e tyre të disponueshmërisë bazohen në Rekomandimin e APP-së Nr. 6732, datë 21.10.2020, për të shmangur angazhimet fiktive.

Është kërkuar **Inxhinier Topograf** për kryerjen e punimeve topografike për nxjerrjen e kuotave të gërmimit, piketimin e saktë të themelit , kollonave dhe soletes te ures.

2.3.4.2 Staf i Punëtorëve të Specializuar dhe Fuqia Punëtore

*Për kryerjen e punimeve, numri i punonjësve (pa përfshirë stafin inxhinierik) duhet të jetë **minimalisht 4 (kater) punonjës te cilet duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën** muajit te fundit (perjashtuar rastit kur jane me kontrate qiraje/sherbimi). Kategorizimi i profesioneve të tyre është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)”, e ndryshuar, si më poshtë:*

a) **1 (nje) Manovratorë / Operatorë** të makinerive të rënda: (Kodi LKP: Grupi 8342 ose Grupi 8343).

Kriteri: Duhet të paraqesin Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) për përdoruesit e makinerive të rënda, të lëshuar nga DPSHTRR ose institucione të autorizuar të formimit profesional, sipas Urdhrit të MIE nr. 200, datë 16.05.2019.

(Shënim: Në rastet e mjeteve me qira me staf, nuk kërkohet deklarimi në listëpagesa, burimi i tyre vërtetohet përmes kontratës së qirasë/shërbimit).

b) **1 (një) Shofer kamioni:** (Kodi LKP: 8332.01).

Kriteri: Shoferët e kamionit duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente.

*(Shënim:*Në rastin kur këto punonjës janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

c) **1 (një) Betonues:** (Kodi LKP: Grupi 7114 - Betonues dhe punëtorë të lidhur me ta).

Kriteri: Duhet të figurojë në listëpagesat e të paktën muajit të fundit përpara datës së dorëzimit të ofertës nën kodin përkatës të LKP-së."

d) 1 (nje) Hekurpunues/Armaturist (Kodi LKP: Grupi 7114 - Punëtorë për përforcimin e betonit / Armaturistë).

Kriteri: Duhet të figurojë në listëpagesat e të paktën muajit të fundit përpara datës së dorëzimit të ofertës nën kodin përkatës të LKP-së."

*((Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues).*

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre.

Kategorizimi i profesioneve të tyre është bërë mbi kodet e përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 (Lista Kombëtare e Profesioneve), duke u përshtatur me mjetet e kërkuara dhe volumet e kantierit si më poshtë:

Manovratorët (Grupi 8342/8343): Janë të domosdoshëm për operimin e ekskavatorëve gjatë gërmimeve për themelet e urës, pilotat, si dhe për përdorimin e makinerive të ngritjes së peshave (vinçave) për montimin e strukturave ose trareve.. Kërkesa bazohet në Urdhrin e MIE nr. 200/2019 për të garantuar sigurimin teknik në kantier.

Shoferi i kamionit (Kodi 8332.01): Kërkohej për transportin e materialeve inerte dhe sjelljen në kantier të materialeve të ndryshme në koordinim me grafikun e punimeve.

"Betonuesi (Grupi 7114): Përfshihet si pozicion kyç për shkak të volumeve kryesore të betonimit të strukturës së urës (themelet, beshkët, muret mbajtëse dhe platforma), duke garantuar hedhjen, ngjeshjen dhe trajtimin e duhur teknik të betonit.

Hekurpunuesi / Armaturisti (Grupi 7114): Rol kritik në fazën e parapërgatitjes dhe montimit të kafazeve të armaturës (hekurit) për të gjitha elementet e beton-armësë së urës, duke garantuar qëndrueshmërinë sipas projektit të zbatimit.

Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listëpagesat E-Sig shërbejnë si mjet objektiv për të certifikuar kapacitetin real dhe organik të operatorit përpara lidhjes së kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri I percaktuar i punonjësve është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **90 diteve** kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m2	40.0								
	Sp+p	op		3.20				0.40	10	0.04	
3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, token zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	73.4								
	Ekskavator 0.25 m3	op				7.34		0.92	10	0.09	
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	73.4								
	Transport me auto vetshkarkuese 3 km	t/km			396.36			0.00		#DIV/0!	
3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	120.0								
	Sp+p	op		33.60				4.20	10	0.42	
	Grejder	op				3.00		0.38	10	0.04	
	Rul (kompresor) me vibrim	op				28.80		3.60	10	0.36	
	Çakell mbeturine per mbushje	m3					28.80				
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	100.0								
	Sp+p	op		1,280.00				160.00	30	5.33	
	Vibrator thellesie	op				164.00		20.50	30	0.68	
	Betonjere 500 liter	op				65.00		8.13	30	0.27	
	Cimento 32.5 N	kg					27,400.00				
	Rere e lare lavatrice	m3					46.00				
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					540.00				
	Uje teknologjik	l					20,000.00				
	Zall (granil) lavatrice	m3					79.00				
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	3.9								
	Sp+p	op		50.18				6.27	10	0.63	
	Vibrator thellesie	op				6.43		0.80	10	0.08	
	Betonjere 500 liter	op				2.55		0.32	10	0.03	
	Cimento 42.5 N	kg					1,148.56				

	Rere e lare lavatrice	m3					1.80				
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					21.17				
	Uje teknologjik	l					784.00				
	Zall (granil) lavatrice	m3					3.10				
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	12.0								
	Sp+p	op		153.60				19.20	10	1.92	
	Vibrator thellesie	op				19.68		2.46	10	0.25	
	Betonjere 500 liter	op				7.80		0.98	10	0.10	
	Cimento 42.5 N	kg					3,516.00				
	Rere e lare lavatrice	m3					5.52				
	Kallep themele e mure me derrasa te veçuara	m2					64.80				
	Uje teknologjik	l					2,400.00				
	Zall (granil) lavatrice	m3					9.48				
2.117/1a	Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m	m3	0.9								
	Sp+p	op		28.41				3.55	10	0.36	
	Vibrator thellesie	op				2.18		0.27	10	0.03	
	Betoni C-20/25 (Me cakell)	m3					0.93				
	Skele inventar	m2					5.46				
	Kallep kollone	m2					9.10				
2.120/1	Trare e arkitrare b/a C16/20 h ~ 8m	m3	4.7								
	Sp+p	op		147.72				18.47	10	1.85	
	Vibrator thellesie	op				12.22		1.53	10	0.15	
	Vinc	op				9.87		1.23	10	0.12	
	Betoni C-16/20 (Me zall)	m3					4.79				
	Skele inventar	m2					18.80				

	Kallep trari	m2					37.60				
2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.5								
	Sp+p	op		27.00				3.38	50	0.07	
	Hekur betoni i periodik Ø 6 - 12 mm2	kg					450.00				
	Tel bari	kg					2.70				
	Vinc kulle 6 - 10 ton	op				0.28			50	0.01	
	Transport auto mbi 10 km				4.50						
2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	4.5								
	Sp+p	op		186.90				23.36	50	0.47	
	Hekur betoni i periodik Ø > 12 mm2	kg					4,450.00				
	Tel bari	kg					13.35				
	Vinc kulle 6 - 10 ton	op				2.80			50	0.06	
	Transport auto mbi 10 km	t/km			44.50						
3.183	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W2	ml	24.0								
	Sp+p	op		41.76				5.22	10	0.52	
	Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W2 + aksesoret	ml					24.00				
	Makineri per montim guard rail	op				7.20			10	0.72	

Totali I materialeve qe do te transportohen	396 ton
Afati I punimeve	90 dite
Sasia e transportuar ne dite	4.4 ton/dite
Rruge kamioni ne dite	1 rruge
Sasia max. e transportuar per 1 rruge	4.4 ton
Kamionat qe nevojiten per transportin e 4.4 ton ne dite	1 kamion ≥ 4 ton

Numri i manovratorëve dhe shoferëve të kamionit është përcaktuar nga numri i makinerive që janë të domosdoshme për kryerjen e punimeve, 2 makineri dhe 1 kamionë, si dhe mbështetur në bashkërendimin dhe mbivendosjen e proceseve të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve.

2.4 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia	
1	Mjet transporti veteshkarkues ≥ 4 ton (kapac. mbajtes)	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Rul me vibrim	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Vibrator thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera
5	Makineri per montim guard rail	1 cope	Në pronësi ose me qera
6	Autobetoniere	1 cope	Në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi me impiant

Si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në momentin e dorëzimit të ofertës në sistemin elektronik:

Për mjetet në pronësi që regjistrohen në regjistra publikë (DPSHTRR): Kopje të vlefshme të lejes së qarkullimit të mjetit, certifikatës së kontrollit teknik (SGS) të vlefshme, siguracionit të mjetit të vlefshëm, si dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit (për mjetet e transportit).

Për mjetet në pronësi që NUK regjistrohen në regjistrat publikë: Dokumentin që vërteton pronësinë e tyre (akte të zhdoganimit në RSH ose fatura tatimore të blerjes).

Për mjetet e marra me qira: Kontratën përkatëse të qirasë (noteriale ose nënshkruar me nënshkrim elektronik sipas ligjit) ku të specifikohet objekti dhe afati i saj që mbulon periudhën e zbatimit të kontratës. Kontrata e qirasë duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentacionin e pronësisë të qiradhënësit (leje qarkullimi, SGS, siguracion ose faturë blerje/zhdoganimi sipas llojit të mjetit).

Shënim : Për mjetin "Autobetoniere", përveç mundësisë së vërtetimit të pronësisë apo qirasë, kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe nëse Operatori Ekonomik paraqet një Kontratë validiteti/Furnizimi me një Impiant (Fabrikë) Betoni të certifikuar, e cila garanton furnizimin dhe transportin e klasave të betonit të kërkuara në projekt-preventiv pranë kantierit të punimeve për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Kjo kontratë furnizimi duhet të shoqërohet me dokumentacionin ligjor të vlefshëm të impiantit të betonit (leje mjedisore/licencë përkatëse dhe certifikatat e kontrollit të fabrikës për klasat e betonit C 16/20 dhe C 20/25).

Deklaratë Disponueshmërie: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se të gjitha mjetet e mësipërme do të vihen në dispozicion të plotë të këtij projekti sipas grafikut të

punimeve. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Rregullat e Prokurimit Publik në fuqi.

((Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues)).

Mbështetur në nenin 26, pika 6 e VKM-së nr 285 , date 19.05.2021, në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e suksesshëm të objektit të prokurimit.

Lista e mjeteve dhe makinerive është përpiluar në raport të drejtpërdrejtë me afatin e zbatimit të kontratës dhe volumet specifike të preventivit të hartuar nga ing. Gzim Likaj .

Mjet transporti vetëshkarkues Është i domosdoshëm për transportin e dherave të gërmuara deri në 3 km larg kantierit, si dhe për sjelljen dhe furnizimin e kantierit me agregatë, çakëll dhe materiale të tjera ndërtimore.

Ekskavator Kërkohet për realizimin e gërmimit të dheut në kanale dhe hapjen e gropës së themeleve për muret mbajtëse të urës.

Rul me vibrim Kërkohet për përhapjen, ngjeshjen dhe stabilizimin mekanik në 3 shtresa të çakëllit të mbeturinave të kaves duke garantuar mbajtjen e kuotave dhe qëndrueshmërinë e shtresës bazë.

Vibrator thellësie Mjet kritik për të gjithë zërat e betonit monolit për të kryer vibrimin e detyrueshëm të betonit në mure, jastëkë, trare dhe soletë, duke shmangur segmentimin e betonit dhe garantuar rezistencën e strukturës.

Autobetoniere Vendoset për të garantuar transportin, homogjenitetin dhe cilësinë e klasave të betonit strukturor (C16/20 dhe C20/25) që do të hidhen në një volum total prej mbi 110 m³. Ky mjet siguron ritëm të pandërprerë të betonimit për të shmangur takimet e ftohta të masës së betonit në elementet mbajtëse të urës.

Kërkesa për paraqitjen e lejeve të qarkullimit, kontrolleve teknike dhe certifikatave të transportit synon të provojë që mjetet janë në gjendje të rregullt pune dhe ligjërisht të gatshme për t'u angazhuar në kantier që në momentin e lidhjes së kontratës, duke shmangur vonesat në grafik.

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë

a) Certifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë **ISO 9001:2015 (të vlefshme)/Ekuivalente:** E akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues nënshkrues të marrëveshjeve të njohjes reciproke (EA/IAF) me Republikën e Shqipërisë.

b) Certifikatën e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor **ISO 14001:2026(të vlefshme)/ Ekuivalente:** E akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues nënshkrues të marrëveshjeve të njohjes reciproke (EA/IAF) me Republikën e Shqipërisë.

c) Certifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë **ISO 45001:2018 (e vlefshme)/ Ekuivalente:** E akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues nënshkrues të marrëveshjeve të njohjes reciproke (EA/IAF) me Republikën e Shqipërisë.

Shënim për Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE): Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, këto certifikime duhet të përmbushen nga secili anëtar i grupit sipas pjesës së zërave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Fusha e zbatimit e certifikatave të mësipërme duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (punime ndërtimi, punime inxhinierie civile apo punime hidroteknike.”

Pranohet që OE të disponojnë/paraqesin **edhe certifikatën për standardin e përditësuar**

Argumentimi:

Kërkesa e cilësisë është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1, si dhe në zbatim të Nenit 44, pikat 1 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kërkesa për certifikata të vlerësimit të konformitetit lejohet vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 i referohet sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe strukturave të organizimit të ndërmarrjeve. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me këtë certifikim me qëllim garantimin e efikasitetit dhe efektshmërisë në menaxhimin e kantierit për objektin “*Ndërtim ure në Bushat, Njesia administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës.*”. Ky standard garanton që operatori aplikon struktura organizative efikase për kontrollin e brendshëm të cilësisë. Meqenëse projekti përbëhet kryesisht nga struktura monolite kritike të betonit dhe montim i armaturave prej hekuri, certifikimi minimizon riskun për defekte strukturore dhe siguron kontroll të rreptë mbi furnizimin dhe derdhjen e materialeve.

ISO 14001:2026 Punimet për ndërtimin e urës pozicionohen mbi ose pranë shtretërve të përrenjve/lumenjve. Menaxhimi mjedisor është i domosdoshëm për të parandaluar ndotjen e

ujërave nga shkarkimet e betonit, për të menaxhuar mbetjet inerte dhe për të minimizuar impaktin eroziv në zonë.

ISO 45001:2018 Ky standard vërteton se operatori ka një plan të certifikuar për parandalimin e aksidenteve në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të stafit në kantier.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit, të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit prej 90 ditësh kalendarikë.

2.7 Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë me Landfillin Bushat, të vlefshme për depozitimin e mbetjeve që krijohen gjatë punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr 10463/2011” Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligji nr 10431/2011” Për mbrojtjen e mjedisit”; nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri lidhet me nevojën për administrimin e ligjshëm të mbetjeve që krijohen gjatë realizimit të kontratës. Ky kriter lidhet me kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin korrekt të kontratës, pasi siguron që mbetjet e krijuara nuk do të depozitohen në mënyrë të paligjshme apo të pakontrolluar, duke shmangur ndotjen e mjedisit dhe pasojat administrative apo penale që mund të rrjedhin nga mosmenaxhimi i tyre, gjithashtu në preventiv përfshihen punimeve germimi, transport materiale, prishje etj. **Kriteri është proporcional dhe i domosdoshëm për natyrën e objektit të prokurimit, pasi garanton që operatori ekonomik ka të siguruar paraprakisht destinacion të autorizuar për trajtimin/depozitimin e mbetjeve.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- ❖ **Për sa i përket specifikimeve teknike, lihet mundësia të paraqitet dhe standartet SSH/UNI/EN/ISO, sipas rastit që aplikohet.**